



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2021:165691

Datë: 26.10.2022

Numri i dokumentit: 03572941

**E.nr.986/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorëve: Sh.S., Sh.I., G.Sh., L.I. dhe S.S., të cilët me autorizim i përfaqëson av Abdurrahim Islami nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 26.10.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përbarimore në lëndën E.nr.986/212, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.986/22, të datës 29.07.2022, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt-Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të ushqimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:165692, të datës 04.04.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 09.09.2022, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,802 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.986/22, më datë 26.10.2022**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**